



Sipas autoritetit të dhënë sipas Nenit 11 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyres së Rregullatorit të Energjisë, në seancën publike të mbajtur më 15.12.2005 miratoi:

KODIN E SJELLJES DHE ETIKËS

Neni 1.

Dispozitat e Përgjithëshme

1.1. Kodi i Sjelljes dhe Etikës (“Kodi”) i Zyres të Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”) vendos parimet elementare të etikës dhe rregullat e sjelljes që qeverisin antarët e stafit. ”Antarët e stafit” përfshijnë të gjithë Antarët e Bordit të ZRRE -së (“Bordi” ose “Antarët e Bordit”) dhe të gjithë të punësuarit e tjerë të ZRRE -së.

1.2. Integriteti i antarëve të stafit është i domosdoshëm për të arsyetuar shkarkimin të drejtë të përgjegjësive të agjencionit rregullativ. Antarët e stafit duhet të marrin pjesë në themelimin, mbajtjen dhe zbatimin e standarteve të larta të sjelljes kështu që respektimi, ndershmëria, paañësia dhe objektiviteti i ZRRE-së të jetë i mbrojtur, dhe të forcohet besueshmëria publike. Kodi jep udhëzime në mbështetjen e përgjegjësive të tyre ligjore dhe etike, dhe duke menjanuar konfliktet e tyre aktuale ose të dukshme të interesit. Dispozitat e Kodit duhet të interpretohen dhe aplikohen për të përcjellur objektivat e vendosura këtu.

1.3. I tërë stafi i kanë borxh ZRRE -së kryerjen e detyrës me qëllim të avancimit të interesave të saj legjitime kur t’ju ipet mundësia për të vepruar kështu.

Neni 2.

Mardhëniet me Ligjet, Rregulloret dhe Standardet

2.1. Të gjithë antarët e stafit pritet që ti përmbushin aktivitetet e tyre në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Kosovë, praktikat e punës të pranuar në mënyrë të përgjithshme, dhe standardet më të larta të etikës.

2.2. Në rastet kur kërkohen udhëzime shtesë për të qartësuar detyrat etike dhe sjelljet e duhura etike, antari i stafit duhet të konsultohet me mbikqyrësin e tij. Nëse kërkohen udhëzime të tilla nga një Antar i Bordit, ai ose ajo duhet të konsultohet me antarët e tjerë të Bordit.

2.3. Shkelja e parimeve etike dhe rregullave të sjelljes të vendosura në këtë Kod janë të ndaluara.

Neni 3.

Konflikti i Interesave

3.1. Asnjë antar i stafit të ZRRE -së nuk duhet të veproj në asnjë që në mënyrë të arsyeshme mund të krijoj përshtypje të arsyeshme në publik se ai ose ajo mund të jetë i angazhuar në sjelljet që shkelin besimin e dhënë atij ose asaj si antare e stafit.

3.2. Asnjë antar i stafit nuk duhet të lejoj që familja, marrëdhëniet shoqërore ose të tjera të ndikojnë në vlerësimet e tij profesionale. Asnjë antar i stafit nuk duhet të përdor, ose te vepron në mënyrë që të krijohet përshtypja e përdorimit të autoritetit dhe mundësit që krijohen për shkak të pozitës e tij ose saj, për të avansuar interesat private të të tjerëve, dhe as nuk bën që një antar i stafit të përcjellë ose lejoj të tjerëve që të krijojnë përshtypjen që në te mund të ndikohet në atë derjtim.

3.3. Për të menjanuar konfliktin e interesave, ky Kod vendos ndalesat për antarët e stafit si në vazhdim:

a) Përveç rasteve të parapara në Nenin 11.2 dhe 11.3 asnjë anëtar i stafit nuk duhet të pranoj të ardhura financiare ose përfitim, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, nga asnjë ndërmarrje e energjisë ose person i punësuar nga ndonjë ndërmarrje e energjisë ose person që kërkon veprim zyrtar nga ZRRE -ja ose i cili përndryshe mund të jetë substancialisht i ndikuar nga vendimet e ZRRE -së. Të ardhura financiare ose përfitimi përfshijnë, por nuk janë të limituara në, para të gatshme, fonde, hua, kredi ose garancione, pasuri të patundëshme, dhurata, udhëtim, qeramarrje, ose shërbime personale;

b) Asnjë anëtar i stafit nuk duhet të ketë ndonjë interes, financiar ose tjetër, të drejtëpërdrejt ose të tërthortë, ose të ushtroj ndonjë kontroll menaxherial mbi operimet e ndonjë ndërmarrje të energjisë të rregulluara nga ZRRE-ja, ose ndonjë pasardhës, ose ndonjë subjekt të kontrolluar drejtëpërsëdrejti ose tërthorazi nga një ndërmarrje e tillë.

c) Asnjë anëtar i stafit nuk mund të jetë i punësuar nga ndonjë ndërmarrje të energjisë njëkohësisht si konsulent ose Antar i Bordit apo në ndonjë pozitë tjetër që mund të shpie në konflikt të interesit;

d) Asnjë Anëtar i Bordit ose antar tjetër i stafit nuk duhet të përdorë të ardhura monetare, qoftë drejtëpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, ndonjë informatë që nuk është në dispozicion për publikun që ai ose ajo e marrin gjatë ose si rezultat i detyrave zyrtare.

e) Situatat e tjera ekzistuese ose të mundëshme që mund të shpiejnë në konflikt të interesit.

3.4. Bordi mund të bëj ndryshimin në lidhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Nen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe kur mbizotëron interesi i përgjithshëm i ZRRE -së.

3.5. Në rastin kur Bordi i ZRRE -së vendos të aplikoj ndryshimin, Bordi do të jap një shpjegim të detajizuar me shkrim për atë vendim.

3.6. Konflikti i interesave mund të mos jetë gjithmonë i qartë dhe evident. Kur një anëtar i stafit ka dyshim nëse një aktivitet i caktuar përbën konflikt të interesit, për veten e tij, saj ose të tjerëve, ai ose ajo duhet të konsultohet me mbikqyrësin e tij ose saj. Anëtari i stafit i cili njoftohet me konfliktin potencial ose konflikt të interesit duhet që t'ia tërheq vërejtjen mbikqyrësit të tij. Një anëtar i Bordit të ZRRE -së i cili kërkon sqarim në lidhje me, ose njoftohet me, një konflikt potencial interesi duhet të konsultohet me anëtarët e tjerë të Bordit.

Neni 4.

Informata Konfidenciale

4.1. Konfidencialiteti nënkupton çdo informatë që nga ZRRE-ja përcaktohet si informatë konfidenciale në bazë të Nenit 3 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe legjislacionin sekondar që aprovohet nga ZRRE-ja sipas Nenit 13 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

4.2. ZRRE-ja do të përcaktoj konfidencialitetin e informatave sipas procedurave të themeluara nga Bordi në lidhje me zbulimin e të dhënave të dorëzuara nga ndërmarrjet e energjisë.

4.3. ZRRE mban të drejtë që të zbuloj informatën konfidenciale nëse vlerëson se interesi i përgjithshëm është më i rëndësishëm se dëmi i krijuar nga zbulimi i tillë.

4.4. Kur ZRRE -ja të vlerësoj informatat konfidenciale gjatë seancave, Bordi duhet të përcaktoj se a do të mbyllë ndonjë pjesë apo tërë seancën për publikun. Materiali nga seanca nuk do të publikohet në internet-faqe ose të zbulohet, përveç për shqyrtim juridik sipas kërkesës nga Gjyqi kompetent.

4.5. Antarët e stafit të cilët kanë qasje në informatat konfidenciale në asnjë kohë gjatë ose pas punësimit në ZRRE nuk mund të zbulojnë, përdorin ose shpërndajnë atë informatë për qëllim tregëtie ose për ndonjë qëllim, përveç për të kryer aktivitetet e tyre për ZRRE.

4.6. Përdorimi i informative të tilla për përfitime financiare personale, ose për të ju sjellur përfitime të tjerëve, nuk është vetëm për tu konsideruar si shkelje serioze e obligimeve të kontratës por mund të rezultoj në iniciimin e procedurave civile ose penale.

Neni 5.

Marrëdhëniet me Konsumatorët, Ndërmarrjet e Energjisë dhe Palët e tjera

5.1. Secili anëtarë i stafit duhet ti respektoj të drejtat dhe të veproj në mënyrë të paanëshme profesionale dhe në mënyrë të drejtë me konsumatorët, ndërmarrjet e energjisë, dhe palët e tjera gjatë përmbushjes së aktiviteteve të tij ose saj.

5.2. Secili anëtar i stafit duhet të përmbush aktivitetin e tij ose saj me qëllim që të ngris, themeloj dhe mbroj parimet e objektivitetit, drejtësisë, paanësisë, transparencës, dhe jo-diskriminimit.

5.3. Asnjë anëtar i stafit, pavarësisht nga pozita e tij ose saj nuk duhet të marrë avantazh të padrejtë ndaj ndokujt përmes manipulimit, fshehjes, abuzimit të informative të privileguara ose të konfidenciale, shtrembërimit të fakteve të materialeve, ose ndonjë praktike tjetër të padrejtë.

Neni 6.

Mardhëniet me Investitorët

6.1. ZRRE-ja është e përkushtuar, në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullative, në mbajtjen e një dialogu aktiv dhe të hapur me palët e interesuara, investitorët e mundshëm dhe investitorët.

6.2. Asnjë anëtar i stafit përveq atyre që janë të autorizuar nuk duhet të kontaktoj, ofroj të dhëna, informata, raporte ose përfaqësoj ZRRE-në para palëve të interesuara, investitorëve të mundshëm ose investitorëve.

Neni 7.

Komunikimi me Mediat

7.1. Përderisa komunikohet me media, anëtari i stafit duhet ti menjanoj referimit dhe pikëpamjet personale, dhe gjatë tërë kohës duhet të veproj në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë Kod. Në asnjë rrethanë nuk duhet që një anëtar i stafit të përdor mediat për të përparuar interesat dhe ankesat e tij, zbuluar informatat e paautorizuara ose të përpiqet që të ndikoj në politiken vendimëmarrëse.

7.2. Anëtari i stafit i cili i kontaktohet nga mediat duhet të marrë aprovim nga mbikqyrësi i tij ose saj para së të komunikoj në lidhje me aktivitetet e ZRRE -së.

Neni 8.

Ambienti, Shëndeti dhe Siguria

8.1. ZRRE -ja do të udhëheq biznesin e vet duke u kujdesur për ambientin, shëndetin dhe sigurinë në përgjithësi.

8.2. ZRRE -ja do të marrë në konsideratë të gjitha legjislacionet e aplikueshme që kanë të bëjnë më mbrojtjen e ambientit.

8.3. ZRRE -ja do të siguroj që secili anëtar i stafit të ketë ambijent të punës të sigurt dhe shëndetëshëm dhe që të gjith legjislacionet e aplikueshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë të zbatohen në ZRRE.

8.4. Secili anëtar i stafit ka përgjegjësi për të mbajtur vendë të punës të sigur dhe shëndetëshëm për të gjithë punëtorët duke i respektuar rregullat dhe praktikat e sigurisë dhe shëndetit, duke raportuar aksidentet, lëndimet dhe paisjet praktikat dhe kushtet e pasigurta.

Neni 9.

Përputhshmëria e Softuerit

9.1. Softueri kompjuterik, doracakët dhe materialet tjera të mbrojtura me të drejtën e autorit dhe të drejtën e pronësisë janë materiale të mbrojtura dhe nuk mund të reprodukohen për përdorim personal.

9.2. Softueri, qoftë i blerë nga shitësi ose i zhvilluar nga ZRRE -ja, është i mbrojtur me të drejtën mbi kopjim dhe poashtu mund të mbrohet përmes patentit ose sekretit tregtar, ose mund të konsiderohet informatë konfidenciale. Softuer i tillë përfshinë programet kompjuterike, bazën e shënimeve dhe dokumentacionin e ndërlidhur. Dispozitat dhe kushtet e marrëveshjes për licencë, sikur që janë dispozitat për të mos kopjuar apo shpërndarë programet, duhet të ndjeken.

Neni 10.

Mbrojtja dhe Përdorimi i Burimeve

10.1. Të gjitha paisjet, sistemet, informatat dhe furnizimet janë resurse që i takojnë ZRRE-së. Të gjithë anëtarët e stafit kërkohet që të mbrojnë dhe me efikasitet të përdorin resurset. Kjo përfshinë përdorimin e Internetit, postës elektronike ose resurset tjera të sistemit informativ. Vjedhja, pakujdesshmëria dhe humbja kanë ndikim të drejtpërdrejtë në profitabilitetin e ZRRE -së.

10.2. Çdo mashtrim apo vjedhje e dyshuar duhet të raportohet menjëherë për hetime.

10.3. Anëtarët e stafit nuk lejohen të përdorin pajisjet për punë private.

10.4. Obligimi për të mbrojtur resurset e ZRRE-së përfshinë edhe obligimin për të mbrojtur informatat për respektueshmërinë e saj.

10.5. Informatat pronësie përfshijnë pronën intelektuale sikur shënimet dhe informatat, sekretet e punës, patentet, produktet e mbrojtura, dhe të drejtat e kopjimit, sikur edhe planet e biznesit, marketingut dhe shërbimit, prospektet dhe interpretimet gjeologjike, idetë inxhinierike, gjeologjike, gjeofizike dhe prodhuese dhe dizajnet, bazat e shënimeve, historitë, informatat e pagave dhe çdo shëim dhe raport financiar të papublikuar.

10.6. Përdorimi ose shpërndarja e paautorizuar e këtyre informative jo vetëm që paraqet shkelje të këtij Kodi por mund të rezultoj edhe me inicimin e procedurës civile apo kriminale.

10.7. Një anëtar i stafit nuk do të blejë apo shes asnjë mjet ose pronë të ZRRE -së pa miratimin paraprak të Bordit. Në rast se Bordi e miraton një blersje ose shitje të tillë, rregullat për prokurimin publik në Kosovë do të aplikohen.

Neni 11.

Dhuratat dhe Zbavitja

11.1. Një anëtar i stafit nuk lejohet të ofroj të mira ose dhurata personale që kanë vlerë më të madhe se modeste që mund të kuptohen si përpjekje për të ndikuar pahijshëm në vendimet e konsumatorit ose furnizuesit ekzistues ose potencial.

11.2. Një anëtar i stafit ose i familjes së tij apo saj nuk lejohet të kërkoj ose pranoj të mira ose dhurata personale që kanë vlerë më të madhe se modeste që mund të kuptohen si përpjekje për të ndikuar pahijshëm në vendimet e konsumatorit ose furnizuesit ekzistues ose potencial.

11.3. Dhënia apo pranimi i ndonjëhershëm i dhuratave që nuk kanë më shumë se 20.00 Euro në vlerë, ushqim, shërbime ose zbavitje është një praktikë e rëndomtë dhe e respektueshme e promovimit të vullnetit të mirë dhe ndërtimit të mbajtjes së marrëdhënieve legjitime të biznesit. Kurtoazitë e tilla të biznesit duhet të jenë jo të shpeshta, të arsyeshme, të rëndomta, ligjore dhe të një vlere modeste. Është e pahijshme të pranohen shujta, pije apo zbavitje në baza të rregullta ose pa e kthyer mirësjelljen në funksione të ndërlidhura me biznes.

11.4. Format e pranushme të zbavitjes mund të përfshijnë mirësjellje të moderuar, jo të rregullt, sikur që janë ngjarjet humanitare, ngjarjet sportive, festat, shfaqjet, koncertet ose ngjarjet tjera kulturore.

11.5. Në asnjë rast një anëtar i stafit nuk lejohet të pranoj të holla të gatshme, udhëtime, mundësi preferenciale për investim, zbritje ose kredi.

Neni 12.

Praktikat e Kontabilitetit

12.1. Është politikë e ZRRE -së që plotësisht dhe në mënyrë fer të publikoj kushtet financiare të ZRRE-së në pajtim me standardet dhe praktikat e aplikueshme ndërkombëtare të kontabilitetit dhe ligjet, rregullat e rregulloret e aplikueshme në Kosovë.

12.2. Librat financiare të ZRRE -së, shënimet, llogaritë dhe deklaratat financiare duhet të mirëmbahen në detaje të arsyeshme, të reflektojnë si duhet transaksionet e ZRRE -së dhe duhet ti përshtaten edhe kërkesave ligjore të aplikueshme edhe sistemit të brendshëm të kontrollit të ZRRE -së.

12.3. Zyrtarë të lartë financiarë të ZRRE -së, përfshirë asistentin financiar ose stafin që kryen funksione të ngjashme, do të përgatisin raporte të brendshme dhe të jashtme dhe deklarata financiare të plota, fer, të sakta, me kohë dhe me të dhëna të kuptueshme bazuar në rregulloret, standardet e aplikueshme dhe praktikat e qëndrueshme të biznesit.

12.4. Është rreptësisht e ndaluar për cilindo Shef departamenti, anëtar të Bordit, menaxher ose çdo anëtar tjetër të stafit të ZRRE -së që të ndërmarrë çfarëdo veprimi ashtu që në mënyrë mashtruese të ndikoj, bind, manipuloj ose keqduhëzoj auditorin e jashtëm të ZRRE-së me qëllim të paraqitjes së deklaratës financiare materialisht keqduhëzuese.

Neni 13.

Ruajtja e Shënimeve

13.1. Të gjithë anëtarët e stafit derisa kryejnë aktivitetet e tyre do të sigurohen se të gjitha të hyrat dhe transaksionet e ndërlidhura me shënimet dhe sistemet e ZRRE-së, përfshirë doracakun dhe informata elektronike, financiare dhe jo-financiare, që shënohen dhe raportohen plotësisht, fer, saktësisht, me kohë dhe në një mënyrë të kuptueshme në pajtim me standardet, ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.

13.2. Të gjitha shënimet do të ruhen dhe mbahen në zyrat e ZRRE -së në departamentet e duhura.

Neni 14.

Aktivitetet Humanitare

14.1. ZRRE-ja është e përkushtuar në mbajtjen e marrëdhënieve të mira me të gjitha organizatat që veprojnë brenda dhe jasht Kosovës.

14.2. Anëtarët e stafit janë të inkurajuar të japin sugjerime për çështjet humanitare për Bordin, i cili do të vendos cilat aktivitete ti përkrah gjatë sesionit të tij të rregullt.

14.3. Anëtarët e stafit janë të inkurajuar, por jo të obliguar, të shërbejnë në cilësi vullnetare në komunitetet ku ZRRE -ja kryen punë.

14.4. Anëtarët e stafit duhet, në çdo kohë, ti shmangen konfliktit të interesit dhe nuk do të marrin pjesë në çfarëdo aktiviteti humnitar që mund të paraqes konflikt interesi.

Neni 15.

Kontributet politike

15.1. Asnjë fond as mjet i ZRRE-së nuk do ti huazohet cilësdo partie politike apo organizate, ose cilitdo individ që mban ose është kandidat për post publik.

15.2. ZRRE-ja është autoritet i pavarur rregullativ. Si e tillë, ajo nuk bën të inkurajoj çfarëdo ndikimi politik ose të angazhim në aktivitete politike.

15.3. ZRRE-ja nuk do të pranoj çfarëdo donacione nga të licencuarit, persona që drejtpërsëdrejti ose tërthorazi janë të kontrolluar nga të licencuarit, partitë politike dhe grupet e lobimit ose asociacionet e konsumatorëve.

Neni 16 Shkeljet

16.1. Shkeljet e standardeve të këtij Kodi mund të rezultojnë me veprime disiplinore, përfshirë por jo edhe kufizuar me ndërprerjen e kontratës, suspendimin, vërejtje me shkrim ose vërejtje me gojë, në pajtim me procedurat e vendosura në legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

16.2. Në arritjen tek vendimi për veprim të duhur, gjërat në vijim do të merren parasysh: serioziteti i shkeljes; historia e kaluar e individit; dhe rrethanat e çështjes në fjalë.

16.3. Një anëtar i stafit që bëhet i vetdijshëm për një veprim që është shkelje e, ose që shpie në shkelje të këtij Kodi, duhet që menjëherë të informoj mbikqyrësin e tij apo saj. Një anëtar i Bordit në situatë të tillë duhet që menjëherë të informoj anëtarët e Bordit.

Neni 17. Anëtarët e Stafit

17.1. Përgjegjësia primare për mbajtjen e një ambienti të sjelljes etike dhe ligjore është tek anëtarët individual të stafit përmes një përkushtimi të demonstruar në nënshtrimin ndaj Kodit dhe të gjitha kërkesave ligjore dhe rregullative që janë relevante për ZRRE-në. Për të kryer përgjegjësinë, anëtari i stafit do të:

- a) Lexoj, kuptoj dhe respektoj këtë Kod dhe të gjitha ligjet dhe rregulloret të aplikueshme për përgjegjësitë e tij të punës,
- b) Kontribuoj për një ambient të vendit të punës që është i favorshëm për dhe inkurajon respektimin e Kodit dhe ligjeve dhe rregulloreve,
- c) Mbajë sensitivitet ndaj sjelljeve të pandehura, aktuale ose të dyshuara joligjore, joetike ose të pahijshme nga furnizuesi, konsumatori, konsulentët ose ndonjë person, ndërmarje apo organizatë tjetër me të cilët ZRRE ka marrëdhënie, dhe ta raportoj një sjellje të tillë tek zyrtarët e duhur të ZRRE.

17.2. ZRRE -ja është fuqimisht e përkushtuar për sigurimin e mundësive të barabarta në të gjitha aspektet e punësimit dhe nuk do të toleroj çfarëdo diskriminimi të cilit do lloj. Të gjitha keqtrajtimet, qofshin ato seksuale, racore, etnike ose të tjera, janë të ndaluara.

17.3. Nëse cilido anëtar i stafit beson që ai ose ajo kanë qenë viktimë e një diskriminimi ose keqtrajtimi, ose din për dikë që ka qenë, ai ose ajo duhet ta raportojë këtë menjëherë tek mbikqyrësi. Një anëtar i Bordit duhet të sjellë një keqtrajtim të tillë në vëmendje të anëtarëve të tjerë të Bordit.

17.4. Anëtarët e stafit do të kryejnë detyrat e tyre të lirë nga ndikimi i çfarëdo lloji droge apo alkooli. Përdorimi, shpërndarja, posedimi dhe shitja e drogës ose përdorimi i alkoolit nga anëtarët e stafit në zyrat e ZRRE -së është e ndaluar;

17.5. Shitja, transportimi, posedimi dhe/ose përdorimi i armëve të zjarrit në zyrat e ZRRE -së është e ndaluar.

17.6. Anëtarët e stafit janë të inkurajuar që të bisedojnë me mbikqyrësit e tyre, menaxherët ose personelin e përshtatshëm rreth sjelljes së parë joligjore ose joetike, ose kur dyshojnë cili është veprimin më i mirë në një situatë të caktuar.

17.7. ZRRE -ja ndalon hakmarrjen ndaj të punësuarve të cilët, me vullnet të mirë, kanë raportuar shkeljet e të tjerëve.

Neni 18. **Menaxhmenti**

18.1. Si shtesë e përgjegjësive të tyre si të punësuar, shefat e departamenteve dhe menxherët në ZRRE duhet të mbajnë një ambient të punës që thekson përkushtimin për respektimin e Kodit dhe ligjeve dhe rregulloreve. Menaxhmenti I ZRRE-së do të:

- a) Siguroj se anëtarët e stafit nën mbikëqyrjen e tyre marrin nga një kopje të Kodit dhe e lexojnë dhe kuptojnë kërkesat e tij;
- b) Sigurojnë se anëtarët e stafit kuptojnë detyrën e tyre afirmative për të raportuar shkeljet aktuale ose të dyshuara të Kodit dhe procedurat e mekanizmat në dispozicion të tyre për të raportuar;
- c) Mbajnë një ambient të punës që parandalon hakmarrjen ose pasojat kundër anëtarit të stafit që me vullnet të mirë raporton shkeljet aktuale apo të dyshuara të Kodit;
- d) Raporton të gjitha shkeljet aktuale apo potenciale të Kodit.

Neni 19. **Komunikimet**

Ky Kod do të komunikohet të gjithë anëtarëve të stafit, do të publikohet në Ueb-faqen e ZRRE-së dhe në buletin e ZRRE-së.

Neni 20. **Obligimet e ish Anëtarëve të Stafit dhe Bordit**

20.1. Ish anëtarët e stafit nuk do të zbulojnë çfarëdo informate që konsiderohet konfidenciale nga ZRRE-ja.

20.2. Ish anëtarët e stafit nuk do të abuzojnë apo shfrytëzojnë përparsinë nga informatat e siguruara derisa kanë kryer detyrat e tyre zyrtare.

20.3. Për një periudh njëvjeçare pas skadimit të mandatit të anëtari të Bordit, ai nuk mund të paraqitet para Bordit në emër të një kompanie të energjisë të licensuar nga

ZRRE-ja, ose me një entitet që në mënyrë direkte ose indirekte kontrollohet nga I licensuri.

Neni 21.
Ndryshimet

21.1. ZRRE-ja e ruan të drejtën që të ndyshoj ose modifikoj çdo dispozitë të këtij Kodi.

21.2. Bordi do të lëshoj dhe miratoj ndryshimet ose modifikimet në Kodin në pajtim me procedurat e aplikueshme për miratimin e këtij Kodi.

Neni 22
Gjuha Zyrtare

22.1. Ky Kod është përpiluar në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

22.2. Në rast të mospërputhshmërisë, verzioni Anglisht do të mbizotroj.

Neni 23
Hyrje në fuqi

Ky Kod hyn në fuqi me datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe publikimit në web-faqën e ZRRE.

Kryesuesi i Board-it të ZRRE

Antarët e Boardit:
